

BIBLIOTEKA

E

SHTETIT

398  
244.

GJIROKASTER

# HIDHE VALLEN LUMA E KUQE

Këngë  
popullore

39  
244.

HIDHE  
VALLEN,  
LUMA  
E KUQE



Këngë popullore  
te mbledhura në Lumë  
nga  
Kamber Zela

32503

## **HIDHE VALLEN, LUMA E KUQE**

Radio Kukësi jep lajmërimë,  
se do t'bahen kudo ndërtimë,  
se do t'bahen projektura,  
kinema e shpi kulture.

- 5 Ku do t'jetë parku i pushimit?  
Buzë liqenit me ujë t'Drinit.  
Lum për brezat që do t'yi një,  
do t'shohin Kukësin si do t'ndrijë!  
Tunde vallen, Luma e kuqe,  
10 se po bahet Kukësi nuse!  
Shih sa shpejt po ndryshon vendi,  
shihet parku, shndrit lijeni,  
majë kodrës, përfund kepit,  
ç'po gjelbron kodra e qytetit.  
15 Shtrihet rruga bregut Drinit,  
ja në liqe varka e peshkimit.

**Kukës**

## VITET E DRITËS, VITET E PARTISE

Vitet e dritës, vitet e Partisë,  
erdhën n'prag me gjak t'vegjlisë,  
zhdukëm terrin, thyem kanune,  
prijmë në ballë të çdo furtune.

- 5 Nandë fshatra nji ekonomi,<sup>1)</sup>  
me banorë mbi pesë mijë,  
kazmë e pushkë fort shtrëngojmë,  
nji pllame tok' t'preket s'lejojmë.  
N'dy anë t'prronit tarraca shkallorre  
10 e kudo, n'mal e bregore,  
mbjellim hardhi e pemë frutore,  
puna fort po na vjen n'dore.

### Bicaj

1) Kooperativa bujqësore «Partizani» — Bicaj, e përbërë nga fshatrat: Canaj, Osmanaj, Mustafaj, Nangë, Bushat, Tërshenë, Gabricë, Kolesjan e Domaj.

## USHTRI E POPULL JEMI NJI<sup>1)</sup>

Qysh atë ditë që leu Partia,  
leu për s'dyti gjith' Shqipnia.  
Nji qëllim na ka bashkue,  
socializmin me ndërtue.

- 5 Ushtri popull jem' bashkue  
për nji qëllim jem' tuj punue.  
Çdo anmik le ta di:  
ushtri-popull jemi nji,  
kazmën n'dorë malit e fushës,
- 10 synin pishë në thep të pushkës.  
Për pa u shkri me gur e mal,  
nuk e lshojmë kët' vend për të gjallë.

---

1) Kënduar në festivalin kombëtar folklorik të Gjirokastrës të vitit 1978.

- Shoku Enver gjithnji ka thanë:  
N'grykë të pushkës anmiqtë na kanë,  
15 kurse ne i kem' n'grykë të topit,  
do t'i kallim n'flak' t'barotit.

### Kukës

## PELLAMBË E ÇELIK

Shqipnia ime,  
e dashuna nanë,  
Partia t'ka veshun  
çelik për çdo pllambë.

5      Në fusha e male,  
kudo kangë e valle,  
bilbili ia thotë,  
s'na tund erë e shqotë.  
Gurgullon bjeshkëve

10     ujët si kristali,  
djersa e klasës  
lule vatani.

Me gjak e djersë  
vadisim Shqipninë,

15     lart, atdhe, fitoret,  
se Partia t'prin!

Bicaj

## BESNIK MADHI I PARTISË PUNËS

Kanë marrë malet nji hije t'ranë,  
dhimbje e madhe ka ra n'kto anë,  
gjysmështize u ngrit flamuri,  
ka pushue zemra e nji burri,  
5 ka pushue zemra e nji trimi,  
loti del, na prek hidhnimi.  
Hysni Kapo, nji trim i rrallë  
fjalurtë e zemërjzarrë,  
vetëtimë shqiponja e luftës,  
10 besnikmadhi i Partisë Punës.  
Fjala e tij si shkam nér male,  
zemrat dridhen, humbje e madhe,  
Enver Hoxha ec ngadalë,  
mban mbi supe nji shok të rrallë,  
15 shokun e dashtun, nji shok lufte,  
trimat mbajnë nji trim mbi supe.

Ndonëse dhimbjen thellë e ndjejmë,  
si gjithnjë, n'forcë do ta kthejmë,  
I pavdekshëm kujtimi i tij,

20 lart më lart, moj nanë Shqipni!

Përbreg

## ÇETËS SË LUMËS

Nantë shtator dyzet e tre,  
na u formue çeta e re,  
çeta e vogël me gjem<sup>1)</sup> prej Kuksi,  
komisar Meriman Jakupi.<sup>2)</sup>

- 5 Po na vjen prefekti në Bicaj,  
kërkon mbledhje për me ba,  
po vjell vner për Partinë,  
hem për çetën, hem për lirinë.
- Atherë gjemtë fort janë shtërngue,
10. në Zbor të Nangëve<sup>3)</sup> e kan' përgjue,  
vranë prefektin në makinë  
me gjithë shokët që n'krah po i rrijnë.  
E jehona fort ushtoi,  
gjer n'Korab ajo kaloi,

15 çeta e vogël radhët i shtoi,  
batalionin ma vonë formoi.

Bicai

- 1) gjem — djem
  - 2) Meriman Jakup Braha (1921-1944) — një ndër komunistët e parë të rrethit të Kukësit, komisar i çetës së Lumës.
  - 3) Toponim në afërsi të fshatit Nang-Bicaj.

## HÉRO I POPULLIT BABË HASANI

N'istori Bicajt e Lumës  
kanë rritë trima t'pushkës e t'punës,  
që kanë dhanë jetën si me le.

- Sot po i këndojmë shqipes me fletë,  
5 partizanit ma t'moçëm n'çetë,  
për respekt çdo partizan  
atë e thirrte babë Hasan<sup>1)</sup>)  
Pra, ky ish Hasan Miftari,  
n'sakrificë ma i pari,  
10 mortaisti harush malit,  
tmerr për cuba t'bajraktarit.  
Gra e fmi ia internuan,  
vajzën fort ia masakrun,  
por s'përkulet zëmërshkami,  
15 Heroi i Popullit babë Hasani.  
N'kullë të Lumës mbi anmik,  
lshonte predhat tanë çelik.  
Bajraktarët i zu belaja,

ç'na i faroi Hasan mortaja.  
20 Mbës Çlirimët n'ballë t'përpjekjes,  
komandant në forca t'ndjekjes,  
shkrep më shkrep e pritë më pritë,  
ka qenë tmerr për çdo bandit.  
N'dyzet e gjashtën<sup>2)</sup> atë ditë marsit,  
25 ushtoi Limthi<sup>3)</sup> i Kolesjanit,  
fyt për fyt me klyshë të tradhtisë,  
heroikisht ra n'krye të detyrës.  
Fli i qetë, Hasan Kërkhalia,  
Hero i Popullit t'bani Partia,  
30 ti je yll që s'shuhash kurrë,  
nëpër shekuj dritë, flamur!

### Kukës

1) Hasan Myftar Kërkhaliu (1902-1946), Hero i Popullit, komunist i orëve të para në rrethin e Kukësit, nga shtëpia e të cilit ranë dëshmorë në Luftën Nacionale Çlirimtare edhe e bija, Havaja, dhe i pipi, Ismaili.

2) Në vitin 1946

3) Mal në afërsi të fshatit Bicaj

## MERIMANI PIKA E DJALIT

Meriman,<sup>1)</sup> ti që n'rini,  
t'u dogj zemra pér liri,  
pér liri t'nanës Shqipni,  
pér trollin ku linde ti.

- 5 N'gjimnaz t'Shkodrës pér studimë,  
rrufeshëm t' nisi malsia trime,  
zune shokë komunista,  
djem të besës e aktivista.  
Meriman, o pika e djalit,  
10 ma aktiv në tanë gjimnazin,  
me gjithë shokë të arrestuen,  
në Tiranë shpejt të dërguen.  
Me shpejtsi kurdise planin,  
nga burgu shokët të dalin,  
15 të dalin shokët me përgjegjësi,  
që i kish kap anmiku i zi.  
Shokët me mall t'përqafuen,  
njerëzit e Partisë t'falënderuen,

marë Shqipnia t'uroi sukses,  
një trim si ti kurr' nuk vdes.  
Në sinorin e Peshkopisë,  
u rrethuen forcat e Halil Alisë.<sup>2)</sup>  
Merimani n'krye t'ushtirisë,  
betejë t'ashpër paska nisë.  
Meriman, o pikë e djalit,  
n'krahnor t'ra plumbi i tradhtarit.  
Fli i qetë, trim i Lumës,  
t'kuajton populli e Partia e Punës!

Kukës

### 1) Meriman Jakup Braha.

2) Një ndër krerët e reaksionit në Shqipërinë e Veriut.

## TO E PA FOTOGRAFINE

N'moshë të re shkollën vazhdove,  
n'njëzet e nantën n'shkollë plotsore,  
djalë i zgjuet, tip i gjallë,  
n'tridhet e tetën n'Shkodër ke dalë.

- 5 To e pamun fotografinë,  
më dukesh si yll që ndrin,  
ftyra jote bardhë si borë,  
sytë e zij porsi shqiponjë.  
N'luftë me shokët partizanë,
- 10 Elez Braha<sup>1)</sup> trim i rrallë,  
në t'shqiponjës batalion,  
i dashun nënkomandant.  
Katërmبëdhetë, muaji dhetor,  
Guri i Kamjes<sup>2)</sup> kishte borë,
- 15 plumbi randë të godet,  
për liri jetën e jep.

N'zemër populli të mban,  
Kuvendi<sup>3)</sup> të dekoron,  
Elez Braha djalë si drague,  
20 Luma kurrë s'ka me t'harrue.

### Bicaj

- 
- 1) Partizan e më vonë nënkomandant i batalionit «Shqiponja», rënë në vitin 1943.  
2) Toponim në rrëthin e Pogradecit.  
3) Kuvendi Popullor.

## HAVA KERXHALIUT

N'male t'Lumës, nëpër shpella,  
një grup tradhtarësh si hije t'zeza,  
n'mejdis t'Lumës, nga këneta,  
na jan' bashkue kto kriminela,  
5 për anmikun tuj ecë fshehtas,  
për anmikun tuj ecë natën,  
për me i çue informatën.  
Informatën i çojnë gjermanit,  
në dam të popullit dhe vatanit,  
10 Hasan Miftari një trim drague,  
me çetën e Lumës asht bashkue.  
Cuca e vet, bijë e vatanit,  
ishte Havaja<sup>1)</sup> e Hasan Miftarit,  
ishte ba ndjeksje e reaksionit,  
15 ishte ba ndjekse për tradhtarin.  
Por tradhtarët e kanë kuptue  
e për Havan ishin betue,  
të gjallë në dorë e kishin lëshue,

shum' e kishin torturue,  
20 kanë vendosë me pushkatue,  
por trimneshë ajo ka qëndrue,  
shum' besnike bija e malsisë,  
edukue, irritë n'gji t'Partisë.  
Ishte bijë e një partizanit,  
25 dalë prej derës së Hasan Mistarit.  
Asnji fjalë nuk p'e tregon,  
porsejeta tash po i shkon.  
Sait Dulla<sup>2</sup>), kryetradhtari,  
mbrapa shpinës i vikati:  
30 —Shifi kodrat, n'majë t'malit,  
ku lufton çeta e Hasanit,  
i ra manzere lules ballit.  
Dimni i ftoftë dyzet e tre,  
u vra Hava, nuse e re.  
35 Vdekja Havan' ka mbulue,  
por kumaniste e fortë ka qëndrue.

### Bicaj

1) Hava Kërkhaliu, aktiviste e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, vrarë nga dora e reaksionit në vitin 1943.

2) I shoqi i Havasë, kriminel pushkatuar nga gjyqi partizan në Bicaj në vitin 1944.

## *LIHJA, MOTRA E MERIMANIT*

Moj sharki e lehtë si era;  
due nji kangë bash si pranvera,  
të njomë si pipin e hardhisë,  
bash si lulet e qershise.

- 5 M'u kujtue një çikë kuksiane,  
Lihja,<sup>1)</sup> motra partizane,  
çikë trimneshë e drejtë e urtë,  
fjala e saj e ambël, e butë.  
Por kur ndeshet me tradhtinë,
- 10 zemërshqype e syvetimë,  
vrullin pishë, ortek ndër rrapi,  
sokoleshë si Jakup Braha.  
Me dorë t'lehtë si fllad në pyje  
për shokët trima qëndis yje.
- 15 La arnoret në rrugë të gajtë,  
nuk pushon as ditë, as natë,  
Motra e mirë e Merimanit  
rritë si lulja brij njaj shkambit.

- Rrezja e zezë duel mbi mal
- 20 Haziz Gashi<sup>2)</sup> bërtet: — Ndal!  
 Jo nuk ndalem, klysh gjermanit,  
 jam e motra e Merimanit!
- Nuk m'frikson qeni i tradhtisë,  
 se jam çika e Shqypnisë.
- 25 Ditë e zezë, një ditë korriku,  
 ra i vllai në pritë të anmikut,  
 sytë e shokëve me lot rigue,  
 Lihja pushkën në dorë shtërngue.  
 Moj sharki e rreptë, e vrantë,
- 30 a i njeve ato ditë gjamët?  
 Kush n'atë shpi ka qëndrue?  
 Kush s'dorzohej tuj luftue?  
 Kush nuk pyet për top t'gjermanit?  
 Lihja, motra e Merimanit.
- 35 Moj sharki, që nuk përkulesh,  
 nëpër tela sot nxjerr lule,  
 kangë e lule mijia-mija,  
 i rreshtojmë ku pushon Lihja,  
 lule t'njoma, që çelin në maj,
- 40 Lihes sonë, vllait të saj.

### Bicaj

1) Lihe Braha, aktiviste e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimi, vrarë nga bombardimet e artilerisë gjermane në vitin 1944.

2) Një ndër krerët e reaksionit.

## ZHURMË E MADHE KAH GOJANI

- Zhurmë e madhe kah Gojani,<sup>1)</sup>  
nam si bani aroplani,  
aroplani pika-pika,  
na e ka çue Amerika,
- 5 Amerika, Inglitera  
për me lshue do kriminela,  
n'parashuta bijnë si gjela,  
Na shkoj fjala der te Puka,  
shkoj në Pukë, te policia,
- 10 t'madhe briti kjo buria,  
piçen bashkë të tanë ushtria,  
tuj u pri Zenel Kadria.<sup>2)</sup>  
Kërset pushka, marshinkë e allti,  
i bijnë Zenelit përmbi si.
- 15 Çka po thotë Zenel Kadria?  
— Mos shikoni, vllazën, plagët e mijë,  
plagët e mijë, ju, mos t'm'i shikoni  
diversantët ju mos t'i lironi,

gjallë a dekë ju në Pukë t'i çoni.

- 20 Aferim, bre Zenel Kadria,  
se ç'ashtu djalë tē mëson Partia.

Kukës

第二十章 當代社會問題（上）

1) Gojan — katund afér Pükës.

2) Zenel Kadria — pjesëtarë në forcat e sigurimit të Pukës, rënë më 28 shkurt 1950.

## XHEMALI BILERI, MORE DJAL' I RI

Xhemali Bileri,<sup>1)</sup> more djal' i ri  
le bankat e shkollës, dole për liri  
flakë e prush në zemër, kushtimi i Partisë,  
s'durova zaptuesit te vatrat e shpisë.

- 5    Në vatrat lumjane ti kamkryq u ule,  
idet' komuniste popullit n'shpirt ia vune,  
demaskim i dhe spiunit, tradhtarit  
syri tak s'të bani përballë bajraktarit.  
Në çetën e Lumës partizani ma i ri
- 10    përkrah babë Hasanit çajshe si veri.  
N'luftë te nulla e Lumës dhe në Fushë-Alie  
veten e tregove si nji bir Partie.  
Kujtojmë dyzet e katrën ditn e nxeh të korrikut,  
s'bashku me dy shokë re në pritë t'armikut
- 15    luftove në kambë, gjoksin barrikadë,  
shokët të kalonin, posta t'shkojë në shtab.<sup>2)</sup>  
Në zallin e Drinit re në fush' të nderit,

sokoli me fletë i Tahir Bilerit.<sup>3)</sup>  
Lapidar ti mbete aty, n'bri të shpatit,  
20 emrin në Mustafaj<sup>4)</sup> ta mban shkoll' e fshatit.  
Gjaku i dëshmorëve Drinit iu bë pritë,  
nga digat e larta Shqipnia merr dritë.  
Në Kukësin e ri n'muze prej mermeri,  
je yll mes yjesh, Xhemali Bileri.

Bicaj

- 1) I ri komunist në krahinën e Lumës, rënë në përpjekje me forcat e reaksionit më 1944.  
2) Shtabi partizan  
3) I ati i dëshmorit  
4) Fshat në rrëthin e Kukësit.

## JEHO, KANGE, SI FLLAD N'PRANVERË

jeħo

Jeho, kangë, si fllad n'pranverë  
për lumjanin pionier,  
për Ismailin e Kérxhalisë,<sup>1)</sup>  
për ndërlidhësin e Partisë!

- 5 N'banka t'shkollës, n'moshë t'fminisë,  
me armiqtë luftën ka nisë,  
ballë kërcnimesh t'çdo armiku,  
pa iu tut' nji herë qerpiku.  
Ish i flakt' agitator,  
10 vigjilent, informator,  
ndiqte rrugën Bicaj-Kukës,  
tuj lidh' qendrën me çetën' e Lumës.  
Nga armiqtë zbuloi sekretin,  
çetës n'pritë ia nxuer prefektin.<sup>2)</sup>
- 15 Trimi i vogël i Vehapit,<sup>3)</sup>  
ndiqte këshillën e babë Hasanit:  
— Që tē mbahesh voc i mirë,  
për armiqtë tē mos kesh mëshirë.

Mbas çlirimët erdh një ditë  
20 kriminelët i kanë dalë n'pritë,  
mbrapa shpine e kanë qëllue,  
rrkej gjaku ka nis' me i shkue.  
Me një deng librash në dorë  
Ismail Kërshalini ra dëshmor.

### Bicaj

- 
- 1) Pionier dëshmor nga fshati Canajët<sup>U</sup>
  - 2) Prefektin e Kukësit<sup>z</sup>
  - 3) I ati i dëshmorit<sup>z</sup>

## NE MES FLAKES TRIM I RRALLE

verset

- Kur shkoi fjala në Gjallicë t'Lumës,  
po loton dhe bregu i Bunës.  
Masi u pa dhe flaka e furtunës  
asht një flak që s'un<sup>1)</sup> e shprehi  
5 e ka mposht Muhamet Shehi.<sup>2)</sup>  
Lufton Buna, Drini e deti,  
në ballë të luftës Muhameti,  
në mes të flakës trimi i rrallë,  
komunist jeton i gjallë.
- 10 Myrtezai, ai djal' i ri,  
nuk kish hi hala n'Parti,  
nuk kish hi n'parti ki emër,  
komunist ai vdiq me zemër,  
fjalët e fundit që i shprehi  
15 inxhinier Muhamet Shehi.  
U hap lajmi në Shqipni  
ka ndigju nana në shpi,  
ndigjoi grueja me gjith' fëmi,

bab Jonuzi<sup>3)</sup> në pleqni,  
20 bab Jonuzi burr' kreshnik  
për një akt kaq heroik.  
Babë Jonuzi tha nji fjalë:  
— Desha të pyes unë për kët' djalë,  
mirë se vdiq në detyrë te furrat,  
25 por a vdiq si vdesin burrat?  
Nana deshi të shikonte,  
dy fjalë t'birit t'ia thonte,  
një ndër djemtë i tha: Moj nanë,  
a mos ke ndonjë fjalë me thanë?  
30 — Bir, o bir, mos u habit,  
se kurr' nana s'asht koritë.  
Edhe pleqt' pra duhen t'mahen<sup>4)</sup>  
mbasi trimat kurr' nuk qahen.  
Foli plaka, shikoi fmija,  
35 çfar' tha plaka kah malsia:  
— Ju kam ju, të rrojë Partia!

### Kukës

1) s'mund, nuk mund

2) Hero i Punës Socialiste

3) Babai i Muhamet Shehut

4) Të mbahen.

## KUKËSIT TË RI

Përreth bjeshkët bajnë çudi,  
shpejt na u rrit ki Kukësi i ri,  
hijeshi ka marrë sot vendi,  
kaltërsi përhap liqeni.

- 5 Sa kanë Drinat ujë e dritë,  
shtohen veprat për çdo ditë.  
Kukësi i ri shumë ka hedhë shtat,  
me Gjallicën<sup>1)</sup> po don m'u matë.  
Për ktë vepër madhështore,
- 10 dora i lumtë klasës puntore.  
Me duart tona ngrëjmë qytetet,  
n'ta ngrihen monumentet,  
i rrëthojmë me trëndafila,  
bac Bajramin, Shote Galicën
- 15 dhe dëshmor Hasan Prishtinën.  
Kuksit ri tetëmbëdhetyçar,<sup>2)</sup>  
po i shndrit djersa në ballë.  
Bulevard dhe rrugë të gjana,

po i rrisim si djalin nana.

- 20 Kangët burojnë si ujët e kronit,  
për m'i këndue ma shum' ktij trollit.  
Fjala jonë gjithmonë ashtë vepër,  
hapi jonë asht kilometër,

## Kukës

Mal në Lindje të qytetit të Kukësit  
i ri filloj të ndërtohet në vitin 1962.

### Historia

1) Mal në lindje të qytetit të Kukësit.

2) Kukësi i ri filloj të ndërtohet në vitin 1962.

## DRITAT E PARTISE

Ushton Gjallica, gjëmon Drini,  
po merr fund elektrifikimi.  
Nga Korabi, Adriatiku,  
prej Gramozi, Koritniku,  
5 si në Jug dhe në Veri,  
në tarraca kodrat i kemi kthy...  
Asht mbushë vendi me gjelbrime,  
në çdo fshat rrugë makine,  
të kisha krah me fluturue  
10 gjithë Shqipninë me e shikue,  
atdheun tonë tuj lulëzue,  
socializmin tuj ndërtue  
se përpara kemi Partinë;  
bahçe me lule ta bajmë Shqipninë!

## Kukës

1971

**II**

## **MURIMI NË KALA**

Të tre vllazënët si janë besatue,<sup>1)</sup>  
kët' kala dojshin me e mbarue.

— Këjo kalaja nuk asht tuj qindrue!

Vllaj i vogël n'kamë asht çue:

— Pritni, vllazën, m'u kallzue,  
pritni andrrën m'e nigjue,  
pa kurban njeri kjo kala s'mun me u mbarue.

Të tre vllaznit si janë besatue:  
grave t'veta mos me u kallzue:

Colla<sup>2)</sup> t'vije bukë për më na prue,  
në murë t'kalasë për me e vënue.<sup>3)</sup>  
Në kala për me e shkri.

I vllai i madh, i vllai i ditë  
besa, t'vogëlin e kanë kobitë,  
grave t'veta u kanë kallzue:  
— Ju n'kala bukë mos me prue.  
Po vjen vakti n'kala me shkue.

Nana nuset asht tuj urdhnue:

— Merre bukën, mori bi!

20 Merre bukën, coa djemve t'mi!

— Jam e smutë, mori nanë, s'muj me shkue.  
Jam e smutë, ori nanë, po më dhem kriet.<sup>4)</sup>

— Nusja e ditë, mori bi!

Merre bukën e çoja djemve t'mi!

25 — Kadalë, nanë të laj qet<sup>5</sup> krie,  
due me shkue, nanë, te prit<sup>6</sup> e mi.

— Nusja e vogël mori bi!

Merre bukën e çoja djemve të mi!

— Kadalë, nanë t'i jap çunit gjji.

30 Se si të shkoj, pale<sup>7)</sup> a do të vi,  
si t'm'i kënosh si zog si plumi,  
në kala do t'shkoj, mori nanë unë,

A ba gati nusja me shkue.

— Lamtumirë, shokë e kojshi,

35 se unë si t'shkoj, pale a do t'vij.

Në kala nusja ka rrri.

— Punë e marë ju kunatët e mi!

— Të marë paçë, kanatë e vogël!

S'e ke pasë renin,<sup>8)</sup> mori, pëse me ardhë?

40 — Mor kunet, he kunetët e mi!

Sall nji fjalë do t'ja la me porosi.

Kur të bani në kala me më shti,

gjinin e majtë t'ma lini jashtë,

Kur tē m'qaj i shejti çun,  
45 tē ma bini, more, ke unë,  
Kjo kala u forcoftë,  
djali i jem mre e gézofté!

### Kukës

- 
- 1) — Me dhanë besën.
  - 2) — cila
  - 3) me vënue, me vu
  - 4) koka
  - 5) Nji këtë
  - 6) Prindërit
  - 7) Ndoshëta
  - 8) Radhën

## NIZAMË S'TË KAM DHANË

Rexha i Matës në Kolesjan,  
po i thotë Shalës<sup>1)</sup> me m'dhanë nizamë!  
— Un' Shala, nizam.s't'kam dhanë,  
veç ti, Rexhë, do hash kryet tan!

- 5 Xhit<sup>2</sup> kanë kodrat që gjimojnë?  
Di Zyberat po luftojnë,  
Zyber Tema e Zyber Fejza  
nuk po i veshin petkat e zeza.  
Lul Simoni nji trajm budall  
10 e shtini Rexhën në bamban.  
Rexha i Matës i Mate Tushës  
shkoj i hini n'magje të bukës.

### Bicaj

1) Kjo këngë i kushtohet luftës së Lumës kundërejtëse Reformave të Tanzimatit; Turqia për të parë herë provoi të mbledhë nizamë në Lumë me anë të renegatit Rexhep pasha nga Ujmishi, që mbeti i vrarë bashkë me njësitin e tij në Nangë nga forcat popullore të Bicajt, që në atë kohë quheshin Shalë.

2) Çfarë.

## N'LUMË KA ARDHË ABDYL TOSKA<sup>1)</sup>

Anë për anë u hap jehona,  
n'Lumë ka ardhë Abdyl Toska,  
Abdyl Frashëri prej Tosknie,  
mendjemprehtë dhe yll lirie.

- 5 E pret Luma si e ka zakon,  
rreth oxhakut kuvendon.  
Thotë Abdyli: — dëgjoni, bre trima,  
me nji gisht nuk shemet Gjallica,  
Mos nigjoni çka thotë tradhtia,  
10 se gegë e toskë nji asht Shqipnia.  
Gjokset tona do i vemë përmbi topa,  
tim e flakë do t'digjet toka.  
Tanë Evropa, more, ban çudi,  
lufton shqipja me shtat' krajli.

## Pobreg

1) Kënduar në festivalin folklorik kombëtar Gjirokastër. 1978.

## POPULLI I LUMËS HIÇ S'KA DERT<sup>1)</sup>

Ka hi serbi n'at' Prizren,  
i thotë Lumës: — Lirom' vend!  
Nuk jam serbi, por jam Luma,  
si ta mbushi shpinën plot plumba.  
5 Bini, djem, thrrët Ramadani,<sup>2)</sup>  
bini, djem, se shkoi vatani!  
Sheja e Luma po shkojn' gjak,  
po i thonë Drinit ndihmom' pak.  
Krali i serbit ban-ò medet,  
10 m'faroi Luma asqerin krejt,  
ma faroi asqerin e ngratë  
burrat me pushkë e grat' me spatë.  
Kadalë, kral, u mblofsh pa varre.  
Populli i Lumës hiç s'ka dert,

15 ka nji luft' e ban p r vjet,  
luft -o me krala e luft-o me mbret.

Lus n

1) Kjo këngë u këndua në festivalin folklorik kombetar, Gjirokastër 1978.

2) Ramadan Zaskoci – luftëtar i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe udhëheqës kryesor i lëvizjes fshatare në Lumë.

## ÇKA PO THOTË KY YMER AGA

Çka po thotë ky Ymer Aga<sup>1)</sup>

Tel këtu pari s'më ka lanë baba,  
jo, po e vijka Ahmet Hasa,<sup>2)</sup>  
sharraxhia që pret drrasa!

5 Ahmet Hasa n'Gur t'Ortunës<sup>4)</sup>  
po ia shkruen vetllat Humës,  
Humë Omuzja e Zize Muja.<sup>5)</sup>  
Sall për Zisen mos kini dert,  
se s'po e lanë vllaznit e vet!

### Shtiqën

1) Mbas shkatërrimit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, turqit, për nënshtrimin e zonës së Lumës më 1884, filluan të vendosnin linjën telegrafike për të lidhur Prizrenin me Bicajn. Në Shtiqën filloi lufta me forcat popullore, të drejtuara nga Ramadan Zaskosi etj.

Ymer Sula, i pari i fshatit Shtiqën, mori iniciativën për të filluar luftën kundër telegrafit.

2) Ahmet Hasa nga Bicaj, oficer në shërbim të Turqisë, që populli e vë në lojë.

4) Guri i Ortunës, një shkëmb mbi fshatin Shtiqën, ku u përleshën forcat popullore me ato turke.

5) Zize Muja, nga Shtiqni, e kunata e Ahmet Hasës, Vëllezërit e saj nuk lejuan që ajo të shkonte të regjistrohej në gjendjen civile turke.

## KRISI PUSHKA E GJËMOI SHKALLA

Krisi pushka e gjëmoi Shkalla,<sup>1)</sup>  
luftë po ban Tesh Mahalla<sup>2)</sup>  
tek po vjen Xhavit pasha,  
Xhavit pasha, faqezi,  
5 ku po e çon, pashë, kët' ordi.  
— Deri n'Lumë due me hi.  
Kur vikat Islam Spahia:  
— Bini, djem, se erdh' Brekia,  
tuj pri para Jemin Alia,  
10 Jemin Alia sahatin me nandë  
Baftjar Doda vjen në Fanë,<sup>3)</sup>  
me do fanë me do arrnorë,  
bijni, djem, t'i zamë me dorë!  
Xhit kanë kodrat që gjimojnë,  
15 di Zenelat po luftojnë;  
di Zenelat, si di bilbila  
fort po i vrasin milazamtë,<sup>4)</sup>  
Zenel Hoxha, Zenel Hasani,<sup>5)</sup>

nuk i kish as gryka as mali.  
20 Kur vikat Ahmet Selmani,<sup>6)</sup>  
tre sahat i ushtoj zani:  
— Bini, djem, se po vritet Ramadani!<sup>7)</sup>

## Bicaj

- 
- 1) Grykë në afërsi të fshatit Bicaj.
  - 2) Mahalla e gurit, sot fshati Mustafaj.
  - 3) Fana, zonë e Mirditës.
  - 4) Milizam, oficer turk, toger.
  - 5) Luftëtarë popullorë nga fshatrat Resk dhe Vilë, rrethi i Kukësit.
  - 6) Fshatarë nga fshati Mustafa (Tërshen)
  - 7) Ramadan Zaskoci

## H A S I M J A

C'ka Hasimja që pisket?

Ja kan' vra vllaznit e vet.

— M'i kanë vra vllaznit e mi,  
hallin vedit s'po ja di.

5 Ku t'më gjinet një trim dai,  
me marrë gjakun vllazënve t'mi?!

Tokë e shpi ia la tapi,  
un' do t'bahem niçahi<sup>1)</sup> i tij.

Del Lil Graca; — Merrëm mue,

10 gjaqet kam me t'i pague!

— Mos, bre Lil, mos u tall me mue,  
se jam femën mos me m' mashtrue.

— Un' t'jap besën e zotit krejt,  
gjaqet do t'i marr sivjet.

15 Kjo Hasimja në kamë asht que,  
fill te vorret shkoi tue vajtue.

Vllajtë të madh mbi krye tue i kallxue:

— Unë, vlla, jam to u fejue,

- pér gjaqet tuja me i pague,  
 20 sot nji javë jam tue shkue,  
 ky Lil Graca po m'merr mue!  
 T'kam pasë dhanë besën jo me u martue,  
 pér gjaqet tuaja jam tu u martue,  
 se ndryshe s'pata si me u pague.  
 25 Në shtëpi të Liles kur ka shkue,  
 rri tri dit' tue u mendue  
 rri tri dit' e rri tri net,  
 pushka e Liles s'po kërset:  
 të tretën e ditës erdhën tre vetë:  
 30 — Ndregna, grue, do jemekë<sup>2)</sup>  
 se më ka ardh birazeli<sup>3)</sup> vetë.  
 Këto jemek si i ka marue,  
 Hasimja rrin tue u kujtue,  
 në mendje të vet e ka hetue,  
 35 paska shkue në derë tue ndigjue,  
 hasmit e vet brenda ia kanë çue.  
 Ky Lil Graca don me u pajtue.  
 Shpejt Hasimja na i ka diktue,  
 merr jemekët qenit ia ka lëshue,  
 40 merr jemekët, qenit ia ka çitë,  
 n'kupë të qjellës në za ka bërtitë:  
 — More Lil, Lil Mema,  
 qysh m'i prune hasmit mrena?!
- Ç'ke, Hasime që je trenue?  
 45 Nxjerrë revolen e jau ka lshue.

- Ka dalë Hasimja për me shkue,  
 me një plakë ishte takue.  
 Uguolla,<sup>4)</sup> bijë, ku je to shkue?  
 A s'po rrin pak me pushue?  
 50 Ah, more mixhë, jabangji kam qëllue,  
 një këtë rrugën me ma drejtue.  
 Asht nisë Hasimja tue kalue.  
 N'dajën e vet ishte takue:  
 — Ç'ke, Hasime, që je tronue?  
 55 — Gjakn e vllazënve e kam pague.  
 A je burrë, dajë, me m'pështue  
 n'dorë të serbies mos me m'lëshue?  
 — Hajt, Hasime, ç'ka po thue?  
 Ty daja ka me t'pështue.  
 60 Në shtëpi fill e ka çue.  
 Shtëpin e dajës e kan' rrethue.  
 — Moj Hasime, me u dorzuë!  
 Fill në postë masi e kan çue,  
 kan' fillue me e gjikue:  
 65 — Pse, Hasime, ke bam' kështu?  
 Kët' revolen me e dorzue.  
 — Vllaznit e mi s'i kam pague.  
 Kryetari shum' e ka qortue.  
 Shpejt revolen m'e dorzue?  
 70 Kjo Hasimja revolen e ka lëshue.  
 N'burg te gratë si e kanë çue,  
 ka ardh çaušhi<sup>5)</sup> m'e kontrollue.

Fill në kam' Hasimja asht çue,  
Disa gra e kan' qortue

- 75 —Pse vjen çaushi këtu me shikue?  
Ne nji çikë aj na asht mësue.  
Kqyr Hasimja, ç'ia ban me sy,  
kqyr, çaushit, sa mirë i asht msy.  
Dekën n'tokë e lëshoj n'testi.<sup>6)</sup>

### Kukës

- 
- 1) Celebri mi, kurora e martesës.
  - 2) Gjellë.
  - 3) Byrazeli, A kur dy shokë pijnë gjak, vëllazërohen.
  - 4) Për hajër qoftë.
  - 5) Oficer turk.
  - 6) Enë balte, që përdoret për të mbajtur uje.

## KANGA E ISLAM SPAHISE<sup>1)</sup>

Shemsi pasha rrin n'seli,  
kqyr kah Vlashnja me dylbi,  
po na vjen nji rrem<sup>2)</sup> ushtri,  
krekj kankan' djem të ri.

- 5 — Islam Spahija para to u pri,  
n'Perzären dojshin me hi.  
Kur vikati Ramadani,  
jallajbeg<sup>3)</sup> na u ba nami.  
Po vjen Mustafa, po vjen Islami,  
10 po na vjen Islam Spahija,  
tan' në kamë asht çue çarshia.  
Tan çarshia, tan Varoshi,  
shkoi haberi te konsollosi.  
Konsollosat<sup>4)</sup> rrafën telin  
15 të shtatë krajlve ua dhanë haberin,  
me trazue allajbegun  
se po djeg Luma Perzärenin.  
Allajbegi po thotë nji fjale:

- Shumë në Lumë kanë dalë murtat.
- 20 Mustaf Lita, he i biri i Manit,  
a s'ja njofte hujet Islamit  
A s'e njofte Islam Spahinë?  
Se n'saraj kërset alltia.  
Për tri ditë t'vij'Destani te shpija!
- 25 Islâm Spahia i hipi atit,  
ia dha flakë atij sokakit,  
di alltije prej dukatit,  
prej dukati, prej florinit,  
s'ia marr dorën sulltan Hamitit.

### Kolesjan

- 
- 1) Islam Spahia, udhëheqës i kryengritjeve popullore, shkon me forcat e tij në Prizren për të liruar nga interimi Destan Kabashin.
- 2) rrem — degë.
- 3) jallajbeg — kononel (turq.)
- 4) konsolloz — konsull.

## HAXHI GASHI<sup>\*)</sup>) NJI DJAL' I RI

Haxhi Gashi trim i shkretë,  
na i ra reni me dalë nebet<sup>1)</sup>)  
na i ra reni nebet me shkue,  
ollomani<sup>2)</sup> i asht afrue.

- 5 — Pse s'ma merr vasijetin<sup>3)</sup> mue?  
— S'ma çon ndera me t'nderue,  
kriçali<sup>4)</sup> ti ke qillue,  
M'atë kamxhik djalit ia ka lëshue.  
Di-tri hapa djali asht prapsue,  
10 dredh mavzeren e ia ka lëshue.  
Dredh mavzeren mirë ia ngjiti,  
t'tana trutë në kalldrëm ia qiti,  
nuk vënoi shumë e duel shpirti.  
Na i duel shpirti e hajmedet,  
15 kish mbetë djali pa fishekë.  
Pa fishekë trimi s'ka çka ban,

merr mavzeren dorzim p'e ban.

Mahmut pasha rri në seli,  
folë nji herë mexhlis i ri.

- 20 — A m'e var djalin a me gri?  
Nuk vanoj shum' e u dha karari:  
Sonte varet Haxhi Gashi.  
Burizani t'madhe piskati,  
tri taborre bahi gati,  
25 bahi gati me u shterngue,  
me Haxhin duen me shkue.  
Fill te drunat e kan que.  
Haxhi Gashit, nji djale i ri  
ia kanë lidhë syt' me shami.  
30 — Mos m'i lidhni syt' me shami  
se nuk jam anadolli,  
jam shqipëtar kosovali,  
flakët e pushkës due t'i shof me sy.  
Haxhi Gashi, nji trim i shkretë,  
35 pesë dekika u kërkon myvlet<sup>5)</sup>  
sall ta shkrujë nji gazetë.  
Të shtatë kralat ta marrin vesh,

---

1) Haxhi Gashi, ushtar shqiptar roje në ushtrinë turke. Instruktori gjerman, që shërbente në ushtrinë turke i kalon para, por ai nuk e përfilli. Për këtë ai e

me shqipëtarin mos me e rreh,  
le t'më kënojë Shqipënia rahmet!

### Morinë

Qëndrohet e fushatës qendore bëri  
Gjithë e lëftëtës është mërturë  
Nëntor qëndrohet e fushatës  
Mësuarët përfundon vrapit qëndrohet  
Bëhet qëndrohet e fushatës  
Nëntor qëndrohet e fushatës  
Mësuarët përfundon vrapit qëndrohet  
Hojnica fusha e fushatës  
Liqiq e fushatës qëndrohet e  
Mësuarët qëndrohet e fushatës  
Mësuarët qëndrohet e fushatës  
Mësuarët qëndrohet e fushatës

---

qëlloi me kamxhik. Haxhiu ktheu pushkën dhe e vrou.  
Për këtë u dënuua me varje. Haxhiu qëndroi para ekze-  
kutimit trimërisht.

- 1) rojë.
- 2) oficer gjerman i dërguar për organizimin e ush-  
trisë turke.
- 3) nderim
- 4) i krishterë.
- 5) afat.

## JETA E TIJ KRISME DO MBETET

Lind n'Zaskoc n'tetqind e gjashtdhetën,<sup>1)</sup>  
me krismë njihet n'shtatdhet e tetën,<sup>2)</sup>  
atidhetar e afirmon vehten,  
duke ndjellë për armiqtë vdekjen.

5 I qan hallet me popullin marë,  
bisedon me çdo fshatar,  
fjalën e tij amël si mjalti  
e ndigjon fëmija e plaki.

10 Lufton kralat, s'duron terrin,  
Shemsi pasha ia sheh sherrin,  
me shokë t'vet ia vret askerin,  
e tund trimi tanë Prizrenin.

Grusht i fortë kundër tradhtisë,  
burrë i besës e bujarisë,

15 për të drejtat e vegjlisë,  
u duk n'Edrene t'Turqisë.  
I pashëm n'trup, i fortë si mali,  
veç për popull e dogji malli,

me Bajram Currin n'Shkup asht besatue,  
me Hasan Prishtinën ka bashkpunue.  
Bilbil kuveni e mendjehollë,  
e njohu Luma me gjithë Kosovë,  
Partia sot për të kujdeset,  
jeta e tij krismë do mbetet.

Bicaj

1) Ramadan Selman Zaskoci.  
2) né vitin 1878.

## N'KAMBË ASHT ÇUÉ TANË MIRDITA

Ditën e djelë kur duel drita,  
n'kambë asht çue tanë Mirdita,  
tanë Mirdita n'kambë asht çue,  
hyqymetin këtu s'e due.

- 5 Hyqymetin vene në Shkodër,  
se këtu i thonë Mirdita e vogël.  
Mirditë e vogël, Mirditë gazepi,  
m'ka lanë baba në nji rrëth kepi,  
te s'luen kali e te s'luen kerri.<sup>1)</sup>
- 10 Këtu s'qet toka bukë për vedи,  
s'ka çka lip as krali as mbreti,  
na pastë më qafë sultani Mehmeti,  
të shtatë kralat i shalakiti<sup>2)</sup>  
na hanger mallin haraç na qiti.

### Surroj

---

1) qerre, karrocë

2) i hutoi

NJI TRIM SI ZANA

- C'po kuvendin nja dy kapedana,  
thonë: — Mirdita paska djem azgana,  
ka Preng Currin<sup>1)</sup> nji trim si zana.  
— Çekso pune kurrë nuk bana,  
5 nuk jam lidhë veç kur m'ka lidhë nana.  
Sot m'ka kapë krali me pranga.  
Qysh m'kà kapë mue krali në gazep,  
dhanë m'i ka mue rrugat me dekë.  
Mos me u kthye kurrë i gjallë n'kët' jetë  
10 Merr Nikolla<sup>2)</sup> nja dy-tre vetë,  
n'Çerret t'vogël pritën po ua zen.  
Seç ju zu pritën në Çerret,  
larg po i shofin hapsorët<sup>3)</sup> e shkretë.  
Lidhë me pranga veçse pa vdekë.  
15 Ka krisë pushka aty me t'shpejtë,  
krisi pushka asht bamë jezer,<sup>4)</sup>  
po shkon gjaku rrugës tanë rrëke.

Thonë: U vranë gjashtë vetë,  
Vret Cuk Sfirin<sup>5)</sup> me gjithë asqer.  
— Gjithë Shqipnisë ia la nji nder,  
nxjerr hapësorët me poterë.

### Kukës

- 
- 1) trim mirditas
  - 2) kushëri i Prengës, që e shpëtoi
  - 3) të burgosurit
  - 4) mjegull e madhe
  - 5) nën oficer austriak

## SHKA PO I THOTE DEMA KADRISE

Shka po i thotë Dema Kadrisë?

S'po ia din renin burrnisë.

— Unë ia dij e ia kem dijtë,  
se për mik gjithmonë jam fikë.

- 5 Po jam fikë e jam rrënue,  
miq e shokë i këm provue,  
kur rashë m'zor s'erdhën me m'nihmue.

— Çe kjo bejte i ka do kajde.<sup>1)</sup>

— Zëne mikun oxhak-zade<sup>2)</sup>

- 10 oxhak-zade prej sojnisë.

## Bushat — Bicaj

1) melodi

2) shtëpi oxhaku

*LUFTA E LUMËS ME XHAVIT PASHËN NË 1909*

- Në Selanik mblidhet hyrjeti,  
mblidhet hyrjeti bahet ordi,  
dymdheth taborre n'Lumë kan' hi.  
Vijnë n'Bicaj, zanatli.<sup>1)</sup>
- 5 Kolesjani shtatdhetë shtëpi,  
kanë ikë rob, kanë ikë robni,  
veç kanë mbetë do djem të ri.  
Kanë rrok hutat e i mbajnë në sy,  
po i mbajnë n'sy, po çesin drejt.
- 10 — Bijni, djem, mos të bahna hyrjet!  
Kurr' hyrjet Luma s'asht ba  
der sa t'mbetet në çika e gra.  
Dy Zenelat si dy bilbilat  
fort po i vrasin mylazimat.
- 15 Zenel Hoxha, nji djal' azgan,  
e ngjesh kollanin mbi xhamadan  
po u thotë shokve: — Mos pini duhan,  
se erdh' asqeri n'Kolesjan,

- n'Kolesjan, n'kulla tē gjata,  
 20 ku po rrinte aj Xhevit pasha.  
 Xhevit pasha rri n'këshilla,  
 shkruen çika e shkruen gra.  
 Del Bicani s'bahet shkja,  
 s'bahet shkja as s'bje nore,  
 25 vjen Tejdrinja sa gjashtë taborre.  
 Vjen Tejdrinja e Lusna e shkretë  
 po vjen Vila me kafe n'xhep.  
 Vila e zezë, ty t'marroftë zoti!  
 S'piqet kafja te kërcet topi.  
 30 Jemin Alia<sup>1)</sup> tufë e fes  
 tanë asqerin, tha, do ta pres,  
 Baftjar Doda vjen me Fanë,<sup>2)</sup>  
 vjen me Fanë, me do Arrnore,<sup>3)</sup>  
 bini, djem, dore, me dore!  
 35 Tanë po brejshin çelik me dhamë,  
 po pvesin pér Ramadan Selmanë.  
 Asht n'Stamboll tue këndue ferman,  
 tue lidhë besën pér vatan.

### Shtiqen

---

1) prijës nga Brekija.

2) me fshatarët e Fanit (Mirditë)

3) prej Arreni, katund në kufi me Mirditën.

## GJAK PËR GJAK

Bilikbashi shilon atin,  
dy kobure prej dukati,  
moj kobure mbeçi shkretë,  
si s'u ndežet kurr' njana vetë,

- 5 gjak pér gjak me Cenin me mbetë.  
Gjak pér gjak me Cenin me shkue,  
me sejmen<sup>1)</sup> Ceni asht tue ardhë,  
kush ma zen Cenin të gjallë,  
dy koburet ia paça falë.
- 10 Thotë Haxhia e za unë!  
— A je këtu, o i lumi Cen!  
— Këtu jam, i lumi Haxhi,  
kafe e duhan unë jam tue pi,  
baj kuvend me vllaznit e mi.
- 15 — Ç'më jep mizhde Cen me t'kallxue,  
nënprefekt, Cen, të kanë emnue,  
nji kaza, Cen, ti me sunue.  
— S'kije besë, Haxhi, me t'besue.

- Pasha mjekrën që kem' lëshue,  
 20 ramazanin që këm axhnue<sup>2)</sup>  
 s'jam n'at rend, Cen, me t'mashtrue.  
 Lokja Cenin fort e ka qertue.  
 — Çou, bre bir, ti mos njefsh me u çue!  
 Qysh Haxhis' mos me i besue?  
 25 Hajt, bre loke, se ke metë pa mue!  
 Hajt, bre loke, se ke metë pa djalë!  
 Krah në krah me Haxhin' tuj shkue,  
 kah shef pasha shumë asht gëzue.  
 — Kapni, qenin, me gujue!  
 30 — Fjalë të randë ke folë, bre pashë!  
 S'kije qen që më kap' mue!  
 C'ka saraji që po dridhet?  
 Deli Cena për kollaj s'po lidhet.  
 C'ka saraji që bubllon?  
 35 Deli Çena me thikë po lufton.

### Bicaj

---

\* Cen Hasani nga Bicaj, ndiqej nga qeveria turke. Me tradhëti e shtinë në dorë. Kur pashë dha urdhër që ta lidhnin, ai qëndroi si burrat duke luftuar me thikë.  
 1) njerëz që qeveria turke caktonte për të mbajtur qetësinë.  
 2) agjëruar.

## *HALIT GASHI ISHTE KANË DJALE*

- Halit Gashi ishte kanë djalë,  
e kapi gjanë e ra në pazar,  
n'baçaxhiun<sup>1)</sup> na ishte zanë.  
I ka lipë baçin e s'ja ka dhanë,  
5 i ka folë nji fjalë të randë,  
i ka sha babë e nanë.  
Dredh martinën e ia ka dhanë,<sup>2)</sup>  
kqyre sa mirë djali ia ngjiti,  
tana trutë n'kalldrëm ia qiti.  
10 Ik Haliti n'skaj t'njij ziti,<sup>3)</sup>  
n'skajt t'nji ziti djali tue shkue,  
tri taborre e kah' rrethue.  
Tek nji kullë, kur paska shkue,  
s'ka gjet burra, paska gjet nji grue.  
15 — Ah, moj nuse, t'paça kunatë,  
sot t'ma mbushish pushkën e gjatë.  
Nusja mbush, Haliti qit.  
— A po ndigjon, more Halit,

po t  vesh nusja nji terlik  
20 t  kap rcej p r kapixhik,  
t  kujtoj pasha mos je  ik .  
— Ah, moj nuse, qejfin ma ke prish :  
me m pas  bamun mue nana  ik ,  
s ma kishte ngjite emnin Halit,  
25 po m  ka ba nana djal ,  
me luftue me pashallar .

### Kuk s

- 
- 1) xhaxhi — ai q  mirrte taks n e bag tive n  koh n  
e sundimit turk.  
2) ia ka l shue  
3) muri

KY SINANI KAÇAK ISHTE KANË

- Ky Sinani kaçak ishte kanë,  
ra n'Dragush me falë t'xumanë.  
Aj katundi monafik<sup>1</sup>) ishte kanë.  
Këtij çaushit haber i kan dhanë:  
5   Në dash, çauš, Sinanin m'e zanë,  
në Dragush po fal' t'xumanë.  
Aj çauhi azgan ishte kanë,  
na i shtrëngon dhetë nizamë.  
Dhetë nizamë i ka shtrëngue,  
10   nga dy bomba ua ka vnu,  
çat xhaminë e ka rrëthue.  
Kur duel hoxha me thirrë eza.  
— Ore Sinan, i ziu Sinan,  
erdh çauhi ty me t'zanë.  
15   — Dil, bre hoxhë, e ban rixha,  
qe nandë vjet kaçak jam kanë,  
qe pesë vjet të x huma s'e kam falë.  
Hiç misade<sup>2</sup> nuk ka dhanë,

- ban çaushi bap e në kambë.
- 20 Po përbëhet<sup>3)</sup> n'din e imanë,  
ndaj xhematin<sup>4)</sup> hoxhë e anë e mbë anë,  
mos të na bahet ndonjë dam,  
se do t'i dal çaushit n'mejdan.  
Krisi pushka me dhetë nizam'.
- 25 — Amanet, hoxhë, ta them nji fjalë,  
kur të vijë lokja n'kerr me m'marrë,  
thuej lokes, mos qajë për mue,  
gjak për gjak me caushin kam shkue,  
dhetë nizamë ia kam teprue.

### Tërshenë

- 
- 1) ngatërrestar
  - 2) afate kohe
  - 3) betohet
  - 4) burgnim

## PËRMBI SY

- Hamëz Aga përmbi dugajë<sup>1)</sup>  
po pëvet dy sheherjanë:  
— A mos e patë kun Ibish Osman?<sup>2)</sup>  
— Atje poshtë tek mejtepi.<sup>3)</sup>
- 5 — A kish pasë noj shoq me vedì?  
— Kish Dautin, Rexhë Mehmetin.  
— Cili asht Rexha unë s'po e dij?  
— Ai që asht pështet për q'atë xhami,  
Kallushan<sup>4)</sup> mustaqezi.
- 10 Sa po i man, Rexhë, këto dhi?  
— T'u rritëjeta, s'janë për ti!  
Janë për dok<sup>5)</sup> e s'janë për gji.  
S'mun t'i mjel' zoja në dimi,  
i mjel malsorja nër xhurdinë.<sup>7)</sup>
- 15 — Mirë po e dij, se çka do ti:  
lipë celinën<sup>8)</sup> përmbi sy,  
përmbi sy, n'lule të ballit,  
ti qes trutë përmes pazarit

Për nji punë që më mloj gazepi,  
20 se më qëlloi lokja me vedi.  
Qëndro loka, mos u pak,  
kqir Hamëz Agën nëpër sokak,  
tuj iu mbushë dollama me gjak!

**Mustafaj**

- 
- 1) dyqan.
  - 2) Ibishi vret Hamid Agën, sepse donte t'i merrte dhitë.
  - 3) shkollë.
  - 4) i pashëm, trupmadh.
  - 5) pamje.
  - 6) për t'u mjelë.
  - 7) xhaketë prej zhguni (shajaku) që mbajnë malësorët.
  - 8) armë e asaj kohe.

SHEJA E LUMA MBUSH ME GJAK

- Në Stamboll po kënon gazeta,  
mjerë dovleti për ilçet<sup>1)</sup> e veta.  
Mjerë dovleti për Rumeli,  
n'Perzeren sërbi paska hi.
- 5 N'Perzeren po ban kuven,  
po i thotë Lumës: liromë ven,  
lirom ven, lirom vatan.  
Reç e Dardhë ranë n'Kolesjan,  
bajnë llogore, bajnë istikam,
- 10 po vjen Doda<sup>2)</sup> me do fanë.<sup>3)</sup>  
Me do fanë, me do arrenorë,  
bini, djem, me dorë, me dorë!  
Ç'po vikat Islam Spahia:  
— Bini, djem, se shkoj Shqipnia
- 15 Ç'po vikat Ramadan Selmani:  
— Bini, djem, se shkoi vatani!  
Bini, djem, ju bini trima  
t'i lamë serbët nëpër zhuvina,<sup>4)</sup>

nëpër zhuvina, t'tanë n'Bushat,  
20 Sheja<sup>5)</sup> e Luma<sup>6)</sup> mbush me gjak,  
po i thotë Drinit nihmo pak,  
Komandanti kampamuk,  
po i këcen dushket porsi uk.  
Komandant, mor biri i kurvës,  
25 nuk po i njef këta djemtë e Lumës,  
që të ndjekin për themër të kundrës.

### Kolesjan

---

1) vendet.

2) Baftjar Doda, luftëtar popullor nga Dibra

3) me trima prej Fanit

4) shkurre (prozhme)

5) Sheja — (përrua) afër Bicaj.

6) Luma — ujë që buron brenda kufirit dhe kalon  
përmes maleve të Gjalicës e Koretnikut e derdhet në  
Drinin e Bardhë tek Kulla e Lumës.

## PËR PA U LA MRIZI ME GJAK...

Vul Çetina<sup>1</sup> hajdut ish kanë,  
në mriz t'Avdis Vula po shkon,  
po i lip dhitë bashkë me kumonë.  
Shif Avdia shka i ka thanë:  
5 — Unë dhitë s'muj me t'i dhanë.  
Unë dhitë nuk t'i jap,  
për pa u la mrrizi me gjak.  
S'kem' ruejtun dhi për Karadak.<sup>2</sup>)  
Shif ky Vula shka po ban,  
10 shpejt pushkën ma rrötullon,  
rrafsh me tokë Avdin po e lshon.  
Ia muer dhitë me gjithë kumonë,  
asht nisë rrugës Vula po shkon.  
More Vulë, Vula i Cetinës,  
15 mirë po t'ndjek cjeipi i Avdisë.  
Nanës Avdisë haberi i ka shkue:

- Sot Avdia jetë kà ndrrue,  
n'Karadak dhitë tè kan' shkue,  
Ka marrë vajin nana tue vajtue,
- 20 kodra e male i ka trishtue,  
tana mrrizet i kà kërkue.  
Mirë po e gjen Avdin' palue,  
nana plakë nis me vajtue:  
— Jam kanë në maxhe tue gatue,
- 25 pushkët e para i kem ndigjue,  
n'loçkë tè zemrës m'kanë përvëlue.  
Mirë e dita se t'kanë shitue,  
tjetër vlla, bir, s't'ka qëllue,  
gjakun tand me ta pague.
- 30 Kurrë ky nam s'asht ba n'Shqipni,  
për me metë kurrë gjak pa u kthyte,  
Sot po jet<sup>3)</sup> gjaku i Avdisë,  
veç n'e martë nera e Shqipnisë.
- 35 Kuku djalë, djalë i jemi, ti djalë.  
Motra e madhe ka nisë me vajtue:  
— Jam kanë n'vek<sup>4)</sup> tuj punue,  
zanin tand e kam ndigjue,  
edhe dhive tuej u fishllue,
- 40 me mend t'mija un' tue kujtue,  
me çfarë vajze me t'fejue.  
Çe kte s'e kam kujtue,

Vul Cetina me tē burgue.  
N'tokē tē zezē ty me t'mbulue,  
45 more kuku, vlla, vllai i em, ti vlla.

**Mholaj**

- 
- 1) Plaçkitës malazias
  - 2) Mali i Zi
  - 3) mbetet
  - 4) tezgjah

## DJALEË DAI

Jemin Hallaçi djalë dai,  
merr Sadikun e bie n'çarshi,  
fjalë ka ba me do shapkali,  
shapkali, dikush thotë nizami,  
5 nam' po ban ki kajmekami.  
Nam po ban, po çalldis buri,  
me rrëthue hanin n'çarshi,  
për me zanë çat Derrin e zi,<sup>2)</sup>  
prapë nizam se u zu sherri,  
10 se n'han tem kollaj s'zihet njeri  
tue pasë shpirtin Mehmet Derri.  
i vot haberi **Brahimit**<sup>1)</sup> në shpi,  
kan' rrëthue Jeminin në çarshi.  
— Shterngom', nanë, vraçin<sup>3)</sup> e zi.  
15 Nji top fishek venja n'dulçi.<sup>4)</sup> )  
Çitma, nanë, pushkën shahi,<sup>5)</sup>  
të shkoj ta nxëjri<sup>6)</sup> qat faqezı,  
se i kam thanë: mas bjerë në çarshi,

- se ti t'hanë cubat me si.
- 20 Fort po ikë juzbashi drumit  
e po i lutet zotit të lomit:  
— Falmi zot krahët e pllumbit,  
porsi pllumbi me fluturue,  
prej Hallaçit sot me pështue.

### Përbreg

- 
- 1) Ibrahim Hallaçi shpëtoi të vëllanë nga burgu i Prishtinës, në kohën e sundimit otoman
- 2) Mehmet Derri, hanxhi, në hanin e tij u zhvillua lufta.
- 3) kalë i zi.
- 4) torbë
- 5) e lustruar
- 6) ta nxjerr

## KANGA E MAHMUT DACIT\*)

- Nji masbat<sup>1)</sup> si i kanë marue,  
te dovleti na e kanë çue,  
Mahmut Dacit s'ju çit, s'ju rrnue,<sup>2)</sup>  
gjysma e dheut<sup>3)</sup> kanë dalë e shkue.
- 5 Janë shem' rrethet e ranë në Vleshë,  
ranë në Vleshë biti<sup>4)</sup> zotni,  
si t'ia bajmë Mahmutit, s'e dij.  
Mahmut Daci nuk po vjen në gjji,  
e kërkon n'gji pasha te çadra,
- 10 bimbash ishte ç'aj Lil Tafa.  
Hipi gjokut Mahmut me shkue,  
edhe ky gjoku s'po ndigjon me shkue.  
De, bre gjok, he pizeveng,  
ku ma din gjelin<sup>5)</sup> tem,
- 15 kam me vejti dyzet djem,  
dyzet djem e shtëjev<sup>6)</sup> përpara,  
i ka votë<sup>7)</sup> pashës te çadra.  
Bimbash ishte Lil Tafa,

bimbash Lila kishte kanë,  
20 e vraftë buka, që i kanë dhanë,  
flokët e nipave pat folë me i marrë.  
Kanë lanë Cenën, çatë Selmanin  
ma të voglin, çatë Muratin.  
T'mirrni atin, të m'ia çojni,  
25 Mahmut Dacit të m'i thoni!  
Mahmut Daci thotë nji fjalë:  
— Mustaf Litën e paça djalë,  
mbajti hasmët e Lil Tafës,  
prev nizamët<sup>8)</sup> e Dervish Pashës.

---

\* Trim nga Kalisi i Lumës.

- 1) shkresë.
- 2) me jetue (nuk jetohej prej Mahmut Dacit).
- 3) krahina.
- 4) krejt
- 5) vdekje.
- 6) shtiu (me shti)
- 7) i ka vajtë.
- 8) preu

## *NUSE SHOTA N'LUFTE KA SHKUE*

Kur po zbrejt Shota<sup>1)</sup> nga kali,  
sa shumë po i shndrit balli,  
i shndrit balli i lirisë,  
asht bijë e Shqipnisë.

- 5 Mbush oborri me dasmorë,  
dy luanë po martojnë,  
po këndoijnë nusen trimneshë,  
për Shqipninë ka lidhë besë.  
Mëngjesi i bardhë në të aguem,
- 10 nuse Shota në luftë ka shkue.  
Hoqi ruaza e jelek,  
ngjeshi gjerdanin me fishekë.  
Mbete ti nuse e luftës  
me gjerdan e me nagant,
- 15 anmiqtë i mbajte në grykë të pushkës,  
shteg më shteg e mal më mal.

### **Shtiqen**

---

1) Shote Galica

## *LUFTA E AZEM GALICES*

Kacë vojvoda a çue n'kamë,  
n'telifon Kaca po shkon,  
naçallnikun pe qërtan.  
naçallnikun te qërtue  
5 tri taborre askerë t'i due,  
Azem Bejtën me rrithet kue,  
se shumë komita te i ka bashkue.  
Kacë vojvoda çka ka marue,  
e ka marrë nji letër te shkrue,  
10 Azem Bejtës me ia çuem.  
Si të duesh, Azem, i gjallë me pështue,  
mblidhni shokët, kullat m'i lëshue,  
se krejt Serbia n'kamë asht çue.  
Se ti probatin më ke qëllue,  
15 po s'kam qarje për pa t'rrethue.  
Letra Bejtës i ka shkue,  
shokët e vet i ka bashkue.  
— Hajdi, shokë, letrën me ngjue,

- naçallniki ma ka çue.
- 20 Tanë Serbia n'kamë asht çue,  
tash po vijnë me na rrëthue.  
Apo çohna kullat m'i lëshue,  
apo shtrëngohna me shka me luftue?
- 25 — S'mujnë, Azem, kullat me i lëshue,  
pushkë e bume na kanë qillue,  
duem me serb na me luftue.  
Del Azemi n'divanhane,  
po shpërthen snëjkt me xhephane,
- 30 shpërthejnë snëjkt e çel frëngjije,  
plot oborri a mushë me shkije,  
plot me shkije, hajmedet,  
Azem Bejte po pisket,  
Kacë vojvodës po i thrrët:
- 35 — More Kacë, ti zoti t'vraftë!  
N'oborr pse ke ardhë?  
Pse ke ardhë me më rrëthue,  
t'ka dashtë nana ma fort se mue?!
- S'kem pas gajle për pa t'rrethue.
- 40 Atherë pushka a fillue,  
krisi pushka nat Galicë,  
paska ngjue Çorri n'Drenicë.  
Çorr Ilazi<sup>1)</sup> nji gjal drague,  
shokët e vet i ka bashkue.
- 45 — Hajdi, shokë, Azemit me i nihmue,  
se ka tri ditë si a rrëthue.

- Janë çue trimat e janë shtrëngue,  
Çorr Ilazi me ta to shkue.  
Çorr Ilazi sa i meçmi ish kanë:  
50 — Nalni, shokë, tertip të bajmë  
nalni, shokë të bajmë tertip,  
t'presim teshat gjenarisht:  
Kah nji setre, nji palë pantoll,  
kah nji palë kundra t'i shtijmë n'kamë,  
kah nji kapele me lule n'ballë.  
A vesh Çorri vetë si zabit,  
e i ka vnué gradat poroçnik,  
i ka çelë drita n'atë Galicë,  
N'atë Galicë, kur kanë ra,  
60 atëherë shkijet i kanë pa:  
po na vijnë gjenart e kralit!  
Kacë vojvoda a çue n'kamë,  
kto gjenar, hej, tibe, nuk janë,  
po Çorr Ilazi, n'koftë i gjallë,  
65 nuk len Bejtes mas pa i ra.  
Po fol Çorri si zabit:  
— Nuk jam Çorri prej Drenice,  
jam nji shka prej Serbije,  
prej Serbije kam qillue,  
70 m'ka çue krali me u ndihmue,  
qe tri ditë se e ke rrëthue.  
Probatin ti t'ka qillue,  
e nji sahat sun ju ke afrue.

Atëherë shkijet kanë besue,  
75 nji sahat nér veti kanë luftue.  
Çorri Ilazi po pisket,  
Azem Bejtes po na i thrret:  
— Pse, Azem, shokët po m'i vret?  
S'po mun Azemi me besue:  
80 na ke vra e na ke coptue.  
Kur ju ep kah ni shehret,  
si vetëtima përjashta ka dalë.  
Ngrika ngrikas kakan marrë  
to ba pushkë, to ba piskamë.  
85 N'at zabel kanë vetë e dalë  
po ban Çorri, hajmedet!  
Shoqi i mirë mue m'paska metë,  
s'ka pasë tjatër nana e vet  
ma pat lanë gjalin amanet.  
90 Azem Bejta thotë: Hajmedet!  
Nusja në kullë mue m'paska metë,  
unë nusen n'kullë s'muj me lanë,  
se shkojnë shkijet e ma zanë.

### Kukës

---

1) shok i Azem Galicës

## NA U TRAND PARISI

Po gérthet polici:  
sepse pushka krisi,  
e u trand Parisi.  
Vallë kush u vra?  
5 — Na u vra Esati.  
Na u shuk<sup>1)</sup> fesati<sup>2)</sup>  
nuk e zu sahati,  
dekun paska ra,  
u përbys tradhtia,  
10 na e vrou Avnia.  
Të pshtojë Shqipnia,  
tradhtia dekun ra.  
Lutet Libohova,  
Dibër e Tetova,  
15 ashtu dhe Kosova,  
për ty, Avni, vëlla.  
Për Esat tradhtarin  
qau Italia

dhe ma fort Serbia,  
20 me lotë tue e qa,  
dekun paska ra.  
Or Avni Rustemi,  
lumt na qe t'kemi,  
lumë Shqipnia vetë.  
25 Kënga ty t'këndohet  
kurrë s'do t'harrohet,  
gjithmonë pa u nda.

### Osmanaj

- 
- 1) u shua
  - 2) ngatërrresë.

## *BAJRAM CURRI I HIPI ATIT*

Bajram Curri i hipi atit,  
gjanë e gjatë po shkon sokatit.  
Ia dha malit, ia dhe shpatit,  
nji selam parisë Gashit,

5 Mujo Hoxhës, Ruštem Bajramit,  
Hoxhëve t'Bytyçit, Ali Binakit.<sup>1)</sup>  
Juve u plaçin dy sytë e ballit!  
Qysh i hani paret e sllavit??!

Qysh e shitët vatanin e djalit??

10 Qysh ia muert fytyrën plakit??  
Për ket' plak mos keni dert,  
Veç nji punë po më jet illet,  
po u shkel sllavi vjet për vjet,

15 po u ha mallin, haraç po u qet.

### **Gostierë**

---

1) Mujo Hoxha, Rustem Bajrami, hoxhët e Bytyçit dhe Ali Binaku, krerë që ranë në kompromis me push-tuesit serbë, për të lëshuar vendin pa luftë, sepse u shitën vetë me para, por populli i mbrojti trojet e veta me grykë të pushkës.

## GRIKË E ZALLIT PO GJEMON

- Hajde, hajde, more Selman Lika,  
sod e sod kanka kanë dita.  
T'ka ardhë dita për nji men,<sup>1)</sup>  
trekind huta si kanë ra te dhentë,  
5 vranë barijtë, na kanë vra sejmenët.  
Pëjti<sup>2)</sup> baba: — cëjlli<sup>3)</sup> gjalë met.  
Met Muslija gjetët rahmet!  
I ngel kollani sall me tre fishekë,  
tre fishekë, sall tri teneqe.
- 10 Priju para, bablok, ketine deshve,  
këtine deshve me kumonë.  
Grikë e zallit, bablok, po gjumon,  
Selman Lika, more, po lufton.  
Selman Lika hutën nér dorë,
- 11 sod po e njef huta të zonë.  
Bini, gjem, bini ju, trima!  
Mos i majni mentë te nuset me cingla.  
Bijni, gjem, bijni ju, burra!

Mos i majni mentë te nuset me tufa.  
20 Selman Lika kqir sahatin,  
metën nuset pa u hjekë duvakin.

### Lusën

---

**Shënim:** Është këngë e vjetër, bën fjalë për mbrojtjen e  
bagëtive nga të huajt që vinin për t'i grabitur.

- 1) me vërtet
- 2) pyeti
- 3) cili

## KURTI E XHEPA SHPETOJNË TUFËN

- N'Kërgëçik sahati m'nandë,  
te kaluen do djem lumjanë,  
bashkë me dhentë janë tue shkue,  
shumë komita i kanë rrethue.
- 5 Shterpa t'trasha u kan' kërkue,  
dashin ogic, kaleshen shterpë.  
— Lum zotenia epëna pak mybet,<sup>1)</sup>  
dersa t'vijnë Kurti e Xhepa.  
Fjala Kurtit i ka shkue:
- 10 — N'Kërgëçik dhentë t'janë ndalue,  
se komitat i kan' rrethue,  
tanë çobanët janë dorzue.  
Atëherë Kurti n'kamë asht çue  
dhe me Xhepën ka kuvenue.
- 15 — Shpejt kuajt me i shtrëngu!  
I thotë kalit: — Vraçk, bre bir!  
Sa ma shpejt n'Kërgëçik me hi!  
Xhepa para ka fillue,

për hava kalin t'e çué,  
20 po don Kurti me kuvendue.  
Asnji fjalë Xhepa s'asht to i kallxue  
lotët pér sojësh Xhepës janë to i shkue.  
— Ðhentë e mijë qish me i nalue!?  
Na të gjallë s'duhet me shpëtue.  
25 Afér dhenve kur kanë shkue,  
me njipherë pushkën kanë fillue,  
tanë komitat i kanë shkatrrue.  
Kurti e Xhepa si di vllazën  
kodër n'kodër po thërrasin,  
30 rrallë po qesin, shpesh po vrasin.  
— Ku u vot<sup>2)</sup> mendja ju zhabëlesh,  
a kujtuet se jam torbesh?<sup>3)</sup>  
S'jem torbesh, as të Çajanë  
ne jemi di djem Lusjanë.

### Lusën

---

1) kohë

2) vajti, shkoi

2) titull ofendues

## RAMEË SADRIA NJI DJALEË I RI

- Ramë Sadria nji djalë i ri,  
po kërkon nëpër kojshi,  
në kojshi Rama tuj kërkue,  
naña e vet fort e ka qortue,
- 5 pesmdhet vjet, bir, t'kam martue,  
ndër kojshi mos me kërkue,  
bukë çobanve n'bjeshkë me u çue.  
Të dy kuajt i ka shtërngue.
- Kur ka dalë Rama n'mejdis të bjeshkës,
- 10 — Mori bjeshkë, — Rama ka thanë —  
që shtatë vjet s'u kam shkelë me kambë,  
më ka marrë malli me këndue nji kangi.
- Kangi Rama ia ka fillue,  
të tanë stanet kanë dalë tue ndigjue.
- 15 — Të lumtë goja i paskanë thanë,  
të shtatë pritat Ramës ia kanë zanë,  
trushëll<sup>1)</sup> n'tokë Ramën e kanë lanë,

- turshëll n'tokë e kanë lëshue,  
rrugës vrrinit janë tue shkue,
- 20 Rrugës vrrinit tue ra n'mahallë.  
Nusja e Ramës ka dalë në shkallë  
po vikat: — Moj e lumja nanë,  
dil e shife djalin tand!  
Djali i yt po t'vjen i vramë.
- 25 — Kush t'tha ty, o mori zanë!  
— I njof teshat që ia dhashë mramë.

### Bicaj

---

1) copa, copa

*Verano 1900. 1000 m. alt.*

En la noche de ayer pasó  
una tormenta de granizo  
que duró casi media hora.  
Algunos truenos y relámpagos  
se oyeron durante la noche.  
En el valle se oyeron  
mucha actividad en los  
valles cercanos. Se oyeron  
varios truenos en el valle  
de la laguna de la  
cabeza de río, que es  
el valle más grande y profundo  
que se observó en el valle  
de la laguna de la  
cabeza de río.

**III**

En la noche del 18 de junio se oyeron  
varios truenos y relámpagos  
en el valle de la laguna  
de la cabeza de río, que es  
el valle más grande y profundo  
que se observó en el valle  
de la laguna de la  
cabeza de río.

## *MOS MA SHTËRGO DOREN*

Mos ma shtërgo dorën  
se s'kam vu kunorën,  
zog i dadës, ylli i natës-o.  
Mos ma shtërgo gishtin  
5 se ma dogje shpirtin,  
zog i dadës, ylli i natës-o.  
Kur do të dal në stan,  
do të t'marr çoban,  
zog i dadës, ylli i natës-o.  
10 Çka kërkon gjithë ditën ?  
Çatë shamisaritën,<sup>1)</sup>  
zog i dadës, ylli i natës-o.  
Mos ta dhashin hakin,  
do ta shes dukatin,  
15 zog i dadës, ylli i natës-o.  
Kur do të rrijmë bashkë,  
do ta djegi me kashtë,

zog i dadës, ylli i natës-o.  
Çka kërkon gjithë natën?

20 Çatë zilifegjatën,  
zog i dadës, ylli i natës-o.

### Bicaj

---

1) shamiverdhën

## *RROJNË DI VAJZA NË NJI KODËR*

Rrojnë di vajza në nji kodër,  
hajde verë, e bardha verë,  
Kanë lidhë besën me shoqja shoqen,  
hajde verë, e bardha verë.

- 5 Ujë të ftohet mos m'e pi,  
hajde verë e bardha verë,  
molla të amla mos me ngranë,  
hajde verë, e bardha verë,  
djelm të rij mos me zanë,  
10 hajde verë, e bardha verë.  
Ma e vogëla çarti besën,  
hajde verë, e bardha verë,  
molla të amla kishte ngranë,  
hajde verë, e bardha verë.  
15 Djalë të ri na kishte zanë,  
hajde verë, e bardha verë,

**Mustafaj**

## KËNOJNI, CUCA, KËNOJNI

Kënojni, cuca, kënojni, se na shkoj kjo darsmë,  
kena, mori, kena, kena Jashar agën.  
Ene kët Jasharin si ta martojmë,  
ene renin Ibishit do t'ia lëshojmë.

- 5 Kcejni, cuca, kcejni, podrumet t'i thejni,  
koftë Jashari shënosh, i paguen me grosh.  
Koftë Jashari vetë, i maron opet.<sup>1)</sup>  
Kënojni, cuca, kënojni, kënojni ene pak,  
se kur të vijë nusja do t'bahna bajat.
- 10 Kësaj nuses Jasharit do t'i nisim kerrin,<sup>2)</sup>  
ksaj nuses Ibishit do t'i rrähim telin.<sup>3)</sup>  
Do t'rrehim telin, për me i kallxue,  
se na renin tej<sup>4)</sup> ta kemi lëshue,

se na renin tej ta kemi lirue,  
15 sexhaden e vjehrrit a e ke marue?

**Mustafaj**

- 
- 1) prapë
  - 2) qerre, karrocë
  - 3) telegram
  - 4) ty

## DHANDËR—O, DHANDËR—E

— Po të vijnë dwersët palë e palë,  
dhandër-o, dhandër-e.

A na i poçe bijat bashkë?

— Bashkë i poça, zahmet<sup>1)</sup> hoça.

5 Po vijnë të grishmit<sup>2)</sup> nëpër ara,  
çou, Jashar, e dilu para!

Grishatarë, paçi faqen e bardhë,  
u kemi grishë e keni ardhë.

Ore Ahmet, e i zoti i shpisë,  
10 çou e çile derën e avllisë!

Çou e çile, more djalë,  
je to martue nji vlla për mallë!

Çou, Jashar, e cil derën e madhe,  
se po vjen Sereni nëpër livadhe!

15 Çile, Jashar, çile, çile derën pak,  
se po vjen Gania nëpër sokak!

Çile, Jashar, çile, çile derën shumë,  
se po vjen Qazimi nëpër katun!

Po t'vijen djersët palë e palë,  
20 to na grishe, to na sajdisë.<sup>3)</sup>  
— To na pjekë miqtë bashkë.  
— Bashkë i poça, zahmet hoça,  
si kandili n'kamë u dogja.  
Kush asht aj si vjen me dash?  
25 Qe ky daxha<sup>4)</sup> bilikbash.  
More daxhë, paç faqen e bardhë!  
Të kemi grishë e ke ardhë.  
More daxhë, ti djalë i ri,  
ti t'u baftë tufa njimi!  
30 Kush asht aj si po vjen me dhi?  
S'paska gjetë nji dash për ti!

### Mustafaj

---

1) mund, zorë.

2) të ftuarit

3) respektuar

4) daja

## O MOJ DELE, DELJA RUDE

Ah, moj dele, delja rudë,  
a s'ma falë nji kingj të butë, verë, verë, aman.  
Kingj të butë lara, lara,  
sall t'i dal beqarit para, verë, verë, aman.

- 5 Ah, moj dele, delja rudë,  
a s'ma fal nji kingj të butë, verë, verë, aman.  
A s'ma fal nji kingj të butë,  
ta kulloti lugë në lugë, verë, verë, aman,  
Lugë në lugë e ferrë në ferrë,  
10 ta çes lala n'atë prendverë, verë, verë, aman.  
Po vjen pula me zog të zi,  
hije t'paskan këto dimi,<sup>1)</sup> verë, verë, aman,  
këto dimi, dimi të gjana,  
venia vedit di nishana, verë, verë, aman.

## Gjegjën

---

1) rrrobe që gratë lumjane veshin në vend të fustanit prej basme.

## *MORI NUSE, LUM KUNATA*

Mori nuse, lum kunata,  
ku i ke rritë këto flokë të gjata?  
— I kam rritë nér kumëll të egër,  
Jashar zogji po çon letër,  
5 po çon letër, po çon selam,  
piçna kafet me sheqer!  
Ki sheqeri fort i amël  
Jashar zogjin e bajmë dhandër.

**Mustafaj**

## MORI NUSE, A PO NDIEN

- Mori nuse, a po ndien,  
se t'u zu kolaçi fillë?!
- Le të më zihet dalëkadalë,  
se prej nanës s'un po dahem.
- 5 — Mori nuse, a po ndien,  
se ta zanë kolaçi fill?!
- Le të më zihet dalëkadalë,  
se prej babës s'un po ndahem.
- Mori nuse, a po ndien,  
10 se ta zanë kolaçi fill?!
- Le të më zihet dalëkadalë,  
se prej vllaznish s'un po ndahem.
- Mori nuse, a po ndien,  
se t'u zu kulaçi fill?!
- 15 — Le të më zihet dalëkadalë,  
se prej motrash s'un po ndahem.
- Mori nuse, a po ndien,

se t'u zu kolaçi fill?!

— Le t'më zihet dalëkadalë,

20 se prej shoqesh s'un po ndahem.

**Shtiqen**

## *MË KANË SI JASHARI PLASI SOT TUJ QA*

Hiçi, Jashar, hiçi flokët e bëqarisë,  
he, të dalshin me shëndet, flokët e dhandrisë.  
Me kanë si Jashari, plasi sot tuj qa,  
i ndami prej nanës sot e elvida.<sup>1)</sup>

- 5 Lidhe, Jashar, besën, lidhe për nji kashtë,  
do ta duesh nanën sikur e ke dashtë,  
Me kanë si Jashari, plasi sot tuj qa,  
i ndami prej babës sot e elvida.  
Lajni, motër, lajni nortat mirë e bardhë,  
10 se dy herë, moj, se dy herë nuk bahem bëqar.  
Me kanë si Jashari, plasi sot tuj qa,  
i ndami prej motrash sot e elvida.  
Lidhe, Jashar, besën, lidhe për nji ftue,  
do të shkojsh te motrat sikur ke pasë shkue.  
15 Mbathi tirqit me gjajtanë, të baj nana dhandër,  
të bajë nana dhandër, hajmedet,  
se ta kem gjetë nusen për t'i bash shidet.<sup>2)</sup>

### **Mustafaj**

---

1) përgjithmonë

2) mrekulli

## *PO VJEN ZOGËJA BREGJIT DRINIT*

Po vjen zogëja bregjit Drinit,  
paska rremat<sup>1</sup> prej florinit.

— N'ato rrema kush përket?<sup>2)</sup>

— I prek dhandri me dorë t'vet.

5 Hajt, moj zoga, hajt,  
hajt, moj lule, hajt.

**Gjegjén**

1) flokët

2) prek

## MË KA ZANË VAPA N'UDHË

- Më ka zanë vapa n'udhë, moj syzezë.
- Lis me dega t'bahem unë, moj syzezë.
- Më ka zanë shiu n'udhë, moj syzezë.
- Shemahijalle<sup>1)</sup> t'bahem unë, moj syzezë.
- 5 — Më ka zanë dimni n'udhë, moj syzezë.
- Sobë me xama<sup>2)</sup> t'bahem unë, moj syzezë.

**Topojan**

---

1) çadër

2) dhomë

*LUEJ, VASHË, E BAN ME DALË*

Luej, vashë, e ban me dalë, oho, luej vashë-o,  
i kuej mallë s'e lenë me dalë, oho, luej vashë-o.  
S'e lenë malli i nanës s'vet, oho, luej vashë-o,  
he i metët hisja shkretë, oho, luej vashë-o,  
5 i metët shkretë, e i metët viran,<sup>1)</sup> oho luej  
vashë-o.

Shkoftë Ibishi e çeltë duqan, oho, luej vashë-o.  
çeltë duqan e çeltë magaze, oho, luej vashë-o,  
nana e vet ishalla plas, oho, luej vashë-o.

**Bicaj**

---

1) i mallkuar

## NA KA DALË NJI VERË E MADHE

Na ka dalë nji verë e madhe,  
na ka ra kosa n'livadhe.  
Del Jashari me kositë,  
tri livadhe për nji ditë,  
5 për nji ditë, për nji sahat,  
shkon fllaza<sup>1)</sup> i rri ngatë.<sup>2)</sup>  
Çit Jashar o tre dukat,  
tre dukat prej xhepit tand.  
Kah të shkojë të vizllojë<sup>3)</sup>  
10 derë e ven ti **hijeshojë**.

**Mustafaj**

---

1) thëllëzë

2) afër

3) të shkëlqejë

## *HAJDE ME GËZIM*

Hajde me gëzim, hajde,<sup>1)</sup>  
në Shtiqën do të hijmë  
Shtiqën do ta kallim,<sup>2)</sup>  
Zanën do t'ua marrim.  
5 Do ta mbjellim grunë,  
ta korrim për dhunë,  
ta mbjellim urov,<sup>3)</sup>  
ta shkulim me dorë.  
Do ta mbjellim rrush  
10 dhe ta hamë me krushq.  
Do ta mbjellim rrush të bardhë,  
ta sheşim në pazar.  
Do ta mbjellim fiq  
dhe ta hamë me miq.

**Mustafaj**

---

1) Përsëritet pas çdo vargu

2) ta djegim

3) bimë që mbillet për bagëti

KUKU, QYQE, JETIM JAM KANE

Kuku, qyqe, jetim jam kanë,  
jetim jamë kanë, jetim jamë rritë,  
se për grosh<sup>1)</sup> mixha m'ka shitë.  
Erdhën krushqit mue me më marrë,  
5 m'kapi mixha m'fugi<sup>2)</sup> n'kalë.  
S'po m'lanë lotët me namë mixhën.  
I thashë mixhës: T'u vraftë gjali,  
qysh me dhe, mixhë, pa m'ardhë vakti.  
Kem kapë udhën, jem to shkue,  
10 n'nji pojatë<sup>3)</sup> jem, ndalue.  
N'nji pojatë si m'kanë ndalue,  
rreth e rreth gratë m'kanë rrethue.  
Kanë marrë kangën tuj këndue,  
kur mi erdhi i lumi aksham.  
15 Kur ia mbrrini i zivi<sup>4)</sup> Hashan,  
kish mbshtjellë kriet me nji jorgan.  
Kish mbush silahin me bagërdan,  
kishte mbushë nji thes me duhan.

Dymdhetë kuti rrëkzinat<sup>5)</sup> n'kambë,  
20 dymdhetë enezë<sup>6)</sup> tirqit e gjanë.  
Kishte këmishin njizet pëllamë.  
Ku m'e gjetë tybe ket' farë burri,  
po i shkon tymi si qyngë pampuri?).  
Nja dy fjalë Hashani m'i ka thanë.  
25 — Dymdhetë gomar me dru me i ngarkue,  
këto te stani përditë me i çue,  
njizet qen përditë me i ushqye.  
Pyeta mendjen tuj kujtue,  
gjithë këto punë s'muj me i marue.  
30 Kuku qyqe, si kam fluturue!

### Kolesjan

- 
- 1) pare e vjetër turke
  - 2) më hodhi
  - 3) formë shtëpie e pa rregulluar
  - 4) i ziu
  - 5) formë peçesh të bëra me lesh dele
  - 6) përdoret në formë metri (matëse)
  - 7) sobë

## *NUSE NUK BAHESH PËRDITË*

Ene, mori nuse, ti e bij' e derrit,  
ti pa dajre mos i hip kerrit.<sup>1)</sup>

Ene ti pa dajre kerrit mos i hip,  
se nuk bahesh, he, nuse përditë!

5 Ene, mori nuse, ti e bij e shkinës<sup>2)</sup>  
ti pa dajre mos i hip makinës.

Pa dajre makinës mos i hip,  
se nuk po bahesh ti nuse përditë.

Kur të vijë nusja kodrës mullinit,  
10 po i shkojshin zhagjë<sup>3)</sup> thekët e qilimit.  
Kur të vijë nusja udhës xhadesë,  
po i shkojshin zhagjë thekët e sexhadesë.

**Bicaj**

---

1) karrocë

2) këtu me kuptimin grua e keqe

3) zvarrë përtokë

## *SHKON DJALI SOKAKIT*

Shkon djali sokakit kunrat tuj kérclue,  
kunrat tuj kérclue, ia hodha nji ftue,  
ia hodha nji ftue, djali s'u kujtue.

- Ti pse s'u kujtove, djalë or teveçel,  
5 ashikja e katunit pér kollaj nuk del.  
Ashikja e katunit don djalë të zgjedhën,  
koporan<sup>1)</sup> Luri me thekë të përdredhun.

**Bushat—Bicaj**

---

1) kapësize, rrobë prej leshi

## *KADIFE, MORI MOLË*

Kadife, mori mollë,  
merre drapnin dil me korrë,  
moj sevda, sevdaja jonë!  
Kadife, mori pjeshkë,  
5 merre gjanë e dil në bjeshkë,  
moj sevda, sevdaja jonë!  
Kadife, mori dardhë,  
merre gjanë e dil në stan,  
moj sevda, sevdaja jonë!

**Canaj**

## *MOLLË E VOGËL Ç'BAN AGJE<sup>1)</sup>*

- Mollë e vogël, ç'ban agje, mollë, ç'ban agje?  
Merre udhën e dil kënej, mollë, dil kënej!  
— Kam nji nanë, s'un p'e lo, dilber, s'un p'e lo.  
— Aso nane gjen kënej, ori mollë, gjen kënej.  
5 Mollë e vogël ç'ban anej, mollë, ç'ban anej?  
Merre udhën e dil kënej, mollë, dil kënej!  
— Kam nji babë, s'un p'e lo, dilber, s'un p'e lo.  
— Aso babë gjen kënej, mollë, gjen kënej.

**Canaj**

---

1) atje

*COU, NUSE, BAHU GJOJTI<sup>1)</sup>*

Duel drita për dollapi,  
cou, moj nuse, bahu gjojti!  
Gjojti jam e hazër s'jam,  
kalë e shalë nuk i kam.

- 5 Mos i paç, çona fjalë  
se ti be kunat' i parë.

**Canaj**

---

1) gati

## *BIR E BIR, DAHIRES ME KAJDE*

- Bir e bir, dahires me kajde,  
veshe jelekin e hajde!
- Bir e bir, dahires me kajde,  
veshe xhumlekun e hajde!
- 5 Bir e bir, dahires me kajde,  
veshi dimijat e hajde!

\*

\* \* \*

Qaqje<sup>1)</sup> poshtë te mullëjni,  
ven nji ujë i trublluëm,  
n'ato ishte mëjtë nji qen;  
10 nuk ishte qen i mëjtën,  
vllaj i nuses i troshëjtën.<sup>2)</sup>  
Të gjithë motrat shkuën me pa  
nusja jonë na ishe da.<sup>3)</sup>

**Osmanaj**

---

1) atje

2) i copëtuar

3) ishte nda

## O HO, HO, SA MËJRË TA BONA

O ho ho, sa mëjrë ta bona,  
si s'të lashë me nëjtë te nana,  
me ngranë kaça e kalamana,<sup>1)</sup>  
me ngranë spec' e patlixhana.

5 Nanë e nuses paska rre,  
thotë e kam nusen e re.  
Prëjtëm vjet, prëjtëm sivjet,  
të na bahesh sa nji plep,  
sa nji plep e sa nji pjergëll,  
10 të na vëjsh nuse me rregjëll.<sup>2)</sup>

**Bicaj**

---

1) fëmijë

2) rregull

*PO DEL MINIA ME KORRË N'ARE*

Po del Minia me korrë n'arë,  
xhanëm, mori Mine, xhanëm,<sup>1)</sup>  
si zabiti me ushtarë.

5 Po del Minia me mçoj kurtin<sup>2)</sup>,  
me nji lule gjranabuti.

Po del Minia n'arë me herrë,  
si fëlloza në pranverë.

**Mustafaj**

---

1) Përsëritet pas çdo vargu

2) për të fshirë oborrin

## GJUNJAS E GJUNJAS<sup>1)</sup>

- Kangë e valle kena sot, e lum-lumo,  
t'kallin cuCAT me barot, lum-lumo,  
hem punëtore hem me shkollë, e lum-lumo,  
Nji bahçe me lule, trëndafila mbrenda,
- 5 kësaj nanës dhandrit iu gëzue zemra,  
iu gëzue zemra e iu ba rahat,  
muer nusen e djalit po si fllanzë e malit.  
Ani, hajt, moj nuse, hiç mos kija dert —  
gjunjas e gjunjas punët i baj vet'.  
10 Ani, hajt, moj nanë, hiç mos kije dert —  
hedhas e hedhas punët i baj vet.  
Ani, hajt, moj nuse, hiç mos kije dert —  
gjunjas e gjunjas grunin e korr vet'.  
Ani, hajt, moj nanë, hiç mos kije dert —  
15 hedhas e hedhas grunin e korr vet'.  
Ani, lumja un' kso nuse kam dashtë —  
hedhas e hedhas punët i bajmë bashkë.

### Bicaj

1) Kënduar në festivalin kombëtar folklorik të Gjirokastrës të vitit 1978

## ÇOU, MOJ CUCË, YLL E DRITË

Mezi prita t'zbardhë kjo ditë,  
s'bashku t'qeshim me gjithë shpirt.  
— Çou, moj cucë, yll e dritë,  
se ti djali asht to t'pritë,

5      ndrit si dielli e si hana,  
kur pér ty, moj, knohet kanga.  
— Hajt, mor djalë, mos u mërzit,  
sa t'u foli njerzve t'shpisë,  
me gaz t'u la lamtumirën,

10     se në ty e kam dëshirën.  
— Bashkë me ty do jetoj,  
pushkë e kazmë s'i lëshoj,  
edhe librin e maj pranë,  
nesër n'punë, ditë e hanë.

15     — Djalë i dadës, mirë po thue,  
punën s'bashku me fillue,  
se Partia na ka msue,  
gëzimi ynë n'punë me i vazhdue.

- Djersët n'punë me i derdh krue,  
20 krah për krah ne me punue.  
Dilni e shihni çiftin e ri,  
punës sot në ballë to i pri,  
nxanës besnik të ksaj Partie,  
para rini, se t'ka hie!  
25 Kështu ja ndrrojmë faqen Shqipnisë,  
dritë i japid gjithë rinisë.

**Bicaj**

## KANGE -TE VJETRA PËR 'KURBETIN

Gjithë verën në bjeshkë, e mjera unë,  
gjithë dimnit në gurbet, e mjera unë,  
shkove, u harrove, e mjera unë,  
nji letër s'ma çove, e mjera unë.

- 5 Sallë ta rujshem në arkë, e mjera unë,  
bashkë me nji palë çorapë, e mjera unë.  
Çorapët me tel, e mjera unë,  
ti m'i paç të çjerrë, e mjera unë,  
të bëj dada kerë,<sup>1)</sup> e mjera unë,  
10 okolla<sup>2)</sup> me tel, e mjera unë,  
mejdisin pamuk, e mjera unë.  
Gjit kërkon gjithë natën, e mjera unë,  
ç'at jelek bojëgjakën, e mjera unë.  
Gjit kërkon gjithë ditën, e mjera unë,  
15 ç'at jelek saritën, e mjera unë.

### Ramhas

---

1) të tjerë

2) rrëth e qark

## *MOJ FUSHË E KORABIT*

- Moj fushë e Korabit,  
o e mjera unë,<sup>1)</sup>  
ti na erdhe hakut,  
ti na ndave shtratit.
- 5 Kur po shkoj me shtrue,  
lotët po më shkojshin krue.  
Kur po shkoj me ra,  
plasa tuj mi qa.
- Shkove, kapërceve,  
10 krejet pse s'e ktheve.  
Pse se ktheve krejet,  
vetë i pate fëjet.
- Kjo feroxhë e gjatë,  
po t'i kputka krahët.
- 15 Kjo feroxhe e shkurtë,  
po t'i kputka gjujtë.  
Kah i çove dhenët plleja?  
Kah kodrat e reja.  
Kah i çove dhenet shterpa?

- 20 Kah kodrat e shkreta.  
Kur po shkoj në krue,  
në maxhe to gatue,  
nana t'u kujtue.  
Pse ti më je vonue?  
25 Met buka pa përvëlue.

### Kalis

---

1) Përsëritet pas çdo vargu

## VIJNË PAMPURAT RRETHIT T'DETIT

Vijnë pampurat rrethit t'detit  
po na vëjn askerët e mretit.  
Gjimsa kojshin,<sup>1)</sup> gjimsa kënojshin.  
Pëse po kajni, ju nizamë?

- 5 Kemi lanë do shpija viran,  
kemi lanë do nuse t'zanë.  
Gjimsat marrë, gjimsat pa marrë.  
Piçna, shokë, të bajmë nji letër.  
Tua çojmë nanave n'atë vilat,<sup>2)</sup>
- 10 për pesë vjet t'na presin gratë.

## Tërshenë

1) qanin  
2) vilajet

## *I HIPA VAPORIT AVASH E AVASH*

I hipa vaporit, avash e avashë,  
tuj kujtue lulen, medet, lulen kuj ia lashë?  
Lulen ia kam lanë nanës amanet,  
le të ma rujë lulen, medet, si di sojt<sup>1)</sup> e vet.

- 5 Lulen s'e harrova, lulen e kujtova.  
Ja bleva mihirin, medet, s'kam pér ka<sup>2)</sup> t'ia çoj  
— Lidhe pér nji krane, lidhe pér nji dru.  
— Kur të dali vera, medet, hajde berma mu.  
— Lulen s'e harrova, lulen e kujtova,
- 10 e kam ble shamin', medet, s'kam pér ka t'ia  
çoj.  
— Lidhe pér nji krane, lidhe pér nji dru.  
— Kur t'frijë era, medet, hajde berma, mu.  
— E kam shkrue nji letër, lules me ia que,  
ka marrë letrën, medet, lulja t'e këndue.
- 15 Ka marrë lulja letrën, medet, te këndue,  
e ka marrë vajin, medet, lulja tuje vajtue.

**Tërshenë**

---

1) sytë

2) me kë, me cilin

## PASQYRE E LËNDES

### I

Hidhe vallen, Luma e kuqe .....	5
Vitet e dritës, vitet e Partisë .....	6
Ushtri e popull jemi nji .....	7
Pëllambë e çelik .....	9
Besnikmadhi i Partisë Punës .....	10
U formue celula e parë .....	12
Cetës së Lumës .....	14
Heroi i Popullit babë Hasani .....	16
Merimani pika e djalit .....	18
To e pa fotografinë .....	20
Have Kërkhaliut .....	22
Lihja, motra e Merimanit .....	24
Zhunmë e madhe kah Gojani .....	26
Xhemali Bileri, more djal' i ri .....	28
Jeho, kangë, si fllad n'pranverë .....	30
Në mes flakës trim i rrallë .....	32
Kukësit të ri .....	34
Dritat e Partisë .....	36

### II

Murimi në kala .....	39
Nizamë s'të kam dhanë .....	42
N'Lumë ka ardhë Abdyl Toska .....	43

Populli i Lumës hiç s'ka dert .....	44
C'ka po thotë ky Ymer Aga .....	46
Krisi pushka e gjëmoi Shkalla .....	47
Hasimja .....	49
Kanga e Islam Spahisë .....	53
Haxhi Gashi nji djal' i ri .....	55
Jeta e tij krismë do mbetet .....	58
N'kambë asht çue tanë Mirdita .....	60
Nji trim si zana .....	61
Shka po i thotë Dema Kadrisë .....	63
Lufta e Lumës me Xhavit pashën më 1909 .....	64
Gjak pér gjak .....	66
Halit Gashi ishte kanë djalë .....	68
Kv Sinani kaçak ishte kanë .....	70
Përmbi sy .....	72
Sheja e Luma mbush me gjak .....	74
Pér pa u la mrizi me gjak .....	76
Djalë dai .....	79
Kanga e Mahmut Dacit .....	81
Nuse Shota n'luftë ka shkue .....	83
Lufta e Azem Galicës .....	84
Na u trand Parisi .....	88
Bajram Curri i hipit atit .....	90
Grikë e zallit po gjëmon .....	91
Kurti e Xhepa shpëtojnë tufën .....	93
Ramë Sadria nji djalë i ri .....	95


### III

Mos ma shtërgo dorën .....	98
Brojnë di vajza në nji kodër .....	100
Kënojni, cuca, kënojni! .....	101
Dhandër-o, dhandër-e! .....	103
O moj dele, delja rudë! .....	105
Mori nuse, lum kunata .....	106
Mori nuse, a po ndien .....	107
Me kanë si Jashari plasi sot tuj qa .....	109
Po vjen zogëja bregjit Drinit .....	110

Më ka zanë vapa n'udhë .....	111
Luej, vashë, e ban me dalë .....	112
Na ka dalë nji verë e madhe .....	113
Hajde me gëzim .....	114
Kuku, qyqe, jetim jam kanë .....	115
Nuse nuk bahesh përditë .....	117
Shkon djali sokakit .....	118
Kadife, mori mollë .....	119
Mollë e vogël ç'ban agje .....	120
Cou, nuse, banu gjojti .....	121
Bir e bir, dahires me kajde .....	122
O ho, ho, sa mëjrë ta bona .....	123
Po del Minia me korrë n'arë .....	124
Gjunjas e gjunjas .....	125
Cou, moj cucë, yll e drithë .....	126

#### IV

Kangë të vjetra për kurbetin .....	130
Moj fushë e Korabit .....	131
Vijnë pampurat rrëthit t'detit .....	133
I hipë vaporit avash e avash .....	134



Zela, K.

Hidhe vallen, Luma e Kuqe.  
Këngë popullore të mbledhura,  
Në lumë [Red.: K. Vasili]. T., «Naim  
Frashëri» 1984.

140 f.

(B.m.) dhe

(B.v.) : 398.8 (496. 5-3)

Z 44

---

Tirazhi 1000 kopje Format 70x100/32 Stash 2204-79

KOMBINATI POLIGRAFIK — Shtypshkronja e Re  
Tiranë, 1984